

VENDIM
Nr. 133, datë 11.2.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.608, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT TË PRONËSISË TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË NDËRTUARA DERI MË 10.8.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDohen AKTE FITIMI PRONËSIE, SI DHE REGJISTRIMIN E TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 25, të ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 74, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.608 datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 8 shtohet pika 8.1, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“8.1. Përfshihet, në rastet e realizimit të projekteve, investimeve dhe shpronësimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike kombëtare ose vendore, institucioni i autorizuar, kryesisht ose me kërkesën e subjektit të interesuar apo subjektit që kryen investimin, fillon dhe përfundon brenda 7 (shtatë) ditëve procedurat e miratimit të kalimit të pronësisë.

Vendimi i institucionit të autorizuar dhe lista e plotë e subjekteve, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi, shoqërohet me:

- dokumentin zyrtar, që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, sipas pikës 5, shkronja “ç”, të këtij vendimi dhe/ose çdo dokument tjetër zyrtar, që provon ekzistencën e ndërtimit para vitit 1991;

- vërtetimin e gjendjes familjare të poseduesit të pasurisë së paluajtshme, para datës 10.8.1991.

Dokumentacioni i mësipërm, së bashku me relacionin tekniko-ligjor, të përgatitur nga institucioni i autorizuar, i dërgohet, menjëherë, zyrës vendore të pasurive të paluajtshme.”.

2. Pas pikës 9 shtohet pika 9.1, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“9.1 Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme kryen procedurat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të trajtuara sipas pikës 8.1, dhe lëshon dokumentin e pronësisë brenda 3 (tri) ditëve. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me lëshimin e dokumentit të pronësisë, njofton, menjëherë, institucionin e autorizuar si dhe subjektin e interesuar apo subjektin që kryen investimin, duke e shoqëruar me dokumentacionin tekniko-ligjor të regjistrimit.

Shpenzimet e nevojshme për regjistrimin e pronës përballohen, fillimisht, nga subjekti kërkues dhe përfitues i projektit dhe i rimbursohen më pas këtij subjekti nga vlera e kompensimit të pronarit, në momentin e likuidimit për efekt të shpronësimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 2

Emër Atësia Mbiemri	Zona Kadastrale	Numri i pasurisë	Loji i Pasurisë	Sipërfaqja	Shënime

